

Thirrje për kompani, OJQ apo individë për të realizuar tri Grafite për OJQ Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) të financuar nga UNICEF.

## TERMAT E REFERENCËS

**Funksioni:** Realizimi i tri Grafiteve

**Lokacioni:** Kosovë (tri komuna të perzgjedhura në bërëkohë)

### Përmbledhje

Si rezultat i pandemisë COVID19, institucionet e Kosovës filluan implementimin e masave për parandalimin dhe mbrojtjen nga COVID-19.

Përqindja e imunizimit të fëmijëve nga komunitetet Ashkali, Egjiptjan dhe Rom e cila ishte e ulët edhe para pandemisë, është ulur edhe më shumë që nga fillimi i pandemisë.

Gjate kësaj periudhe, institucionet shëndetësore kanë drejtuar resurset ekzistuese kryesisht në luftën kundër Coronavirusit dhe imunizimi i fëmijëve nuk është kryer sipas kalendarit të vaksinimit. Poashtu, për shkak të frikës nga infektimi nga Coronavirusi, por në disa raste edhe vetëdijësimin të ulët për imunizim, prindërit e këtyre fëmijëve nuk kanë dërguar fëmijët për imunizim sipas kalendarit të rregullt të imunizimit.

Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) është duke implementuar projektin e financuar nga Zyra e UNICEF në Kosovë i cili ka për qëllim kryesor rritjen e ndërgjegjësimin dhe imunizimin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë. Projekti realizohet në 6 komuna të Kosovës: Fushë Kosovë, Shtime, Obiliq, Gjilan, Ferizaj dhe Lipjan.

Në kuader të projektit, BSFK është duke implementuar një hulumtim për të mbledhur informata për situatën e imunizimit të fëmijëve të moshës 0-7 në 6 komuna, në bazë të të cilit BSFK do të strukturojë një databazë me informata për fëmijët që kanë nevojë të imunizohen. Databaza do të ofrohet institucioneve përgjegjëse.

BSFK do të asistojë institucionet shëndetësore në imunizimin e fëmijëve përmes vullnetarëve në terren. Vullnetarët e BSFK do të vizitojnë familjet nga këto tri komunitete me qëllim të rritjes së vetëdijësimin për rëndësinë e imunizimit.

### Objektivi:

Objektivi kryesor i tri Grafiteve të synuara përmes thirrjes është rritja e vetëdijësimin të komuniteteve Ashkali, Egjiptjan dhe Rom në Kosovë për rëndësinë e imunizimit.

### Qëllimi i punës:

Kompania, OJQ apo individët e perzgjedhur do të:

- Dizajnoj së paku 6 koncepte në verzionin elektronik për Grafite, tri prej tyre do të përzgjedhen për tu punuar në realitet.
- Ndërlidhë konceptet e grafiteve me objektivat e projektit. Në rast që konceptet nuk janë të ndërlidhura me objektivat e projektit, duhet të dizajnohen koncepte të tjera.
- Koordinon me BSFK lokacionin dhe kohën e punimit të grafiteve. Grafitet duhet të finalizohen deri në fund të 15 Dhjetorit 2020.

- Merr persipër koston e te gjitha materialeve për punimin e grafitëve, duke përfshirë edhe logjistiken (transport, komunikim, ushqim, etj).
- Punon Grafitet me material kualitativ. Preferohet garancioni I qëndrueshmërisë së Grafitëve në propozim financiar nga kompania.
- Siguron dhe garanton origjinalitetin e konceptit.
- Të koordinojë zhvillimin e Grafitëve me BSFK dhe ta konsideroj finale pas aprovimit nga BSFK.

Grafitet mund të përfshijnë fragmente të punës së vullnetarëve në teren lidhur me imunizimin, aktivitete të realizimit të imunizimit në teren apo institucione shëndetësore, deklarata nga përfituesit (prindërit e fëmijëve), dhe/ose elemente të tjera.

Kompania ose OJQ duhet:

- Të jetë e regjistruar në Kosovë;
- Të ketë përvojë minimale prej 2 vjetësh në fushën e objektivave të thirrjes.
- Përvoja e mëparshme e punës.

Individët duhet të:

- Dërgojnë CV e cila përshkruan përvojën e punës në lamin e kërkuar në këtë thirrje.
- Dëshmojnë që kanë kapacitet për të përfunduar punën.
- Ofrojnë referenca për punë të ngjajshme.
- Posedojnë dokumente valide për të lidhur kontratë angazhimi

Palët e interesuara duhet të dërgojnë këto dokumente:

- Shembuj nga materialet apo grafitet e zhvilluara.
- Konceptet e tri Grafitëve (mënyrë elektronike).
- Çimimi I ofertes.

**Afati i aplikimit:**

Kompanitë e interesuara duhet të dërgojnë dokumentet e tyre të aplikimit (të përmendura më lartë) në emailin: [applications@balkansunflowers.org](mailto:applications@balkansunflowers.org)

Afati I fundit për dërgimin e ofertave është 17 Nëntor 2020 ora 15:00

Për çdo pyetje teknike që lidhet me kërkesën tuaj, ju lutemi na kontaktoni në:

[office@balkansunflowers.org](mailto:office@balkansunflowers.org)